REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SARANDË
KËSHILLI

VENDIM

Nr 43, Datë 23.12.2019

MBI MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SARANDË PER VITIN 2020

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015"per veteqeverisjen Vendore", neni 9 pika c dhe ç, neni 54 germa ç dhe dh, Ligji 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë",Ligji nr. 68 date 27.04.2017"Per financat e veteqeverisjes vendore" ,UMF nr.2, date 06.02.2012" Per procedurat standarte te Zbatimit te Buxhetit", VKB nr,65 date 22.10.2019 "Per miratimin e buxhetit afat mesem , si dhe te VKB nr 36 date 06.12.2019," Per miratimin e paketes fiskale", Këshilli Bashkiak ,

VENDOSI:

1. Të miratojë buxhetin e Bashkisë Sarandë për vitin 2020 në përbërje:

I. Te Ardhurat Vendore		**1,294,725**	**mije lek**
i.	**Të ardhurat e veta**	**426,500**	**mije lek**
ii.	**Të ardhura nga transferta e pakushtezuar**	**129,131**	**mije lek**
iii.	**Te ardhura te trasheguara nga viti 2018**	**222,105**	**mije lek**
iv.	Grande per investime nga buxheti i shtetit	200,000	mije lek
v.	Transferta Sektoriale	101,989	mije lek
vi.	Transferta te kushtezuara	215,000	mije lek
II. Shpenzimet Vendore		**1,294,725**	**mije lek**
a.	**Shpenzime per paga dhe sig shoqerore**	**291,142**	**mije lek**
b.	**Shpenzime Operative**	**295,584**	**mije lek**
c.	**Transferta te ndryshme**	**256,500**	**mije lek**
d.	**Shpenzime kapitale**	**451,499**	**mije lek**

2. Te miratoje ze per ze te ardhurat dhe shpenzimet sipas tabelave bashkengjitur relacionit.

3. Te miratoje numrin e pergjithshem te punonjesve te Bashkise dhe institucioneve ne varesi te saj, i cili do jete i pandryshuar **410 punonjes**.
4. Ndryshimet ne te ardhurat e trasheguara nga rakordimet e fundvitit me thesarin, te prekin zerin e investimeve publike.
5. Per pregatitjen e e ketij P/Vendimi jane ngarkuar drejtorite perkatese
6. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohen Drejtorite, dhe njesite shpenzuese ne varesi te Bashkise.
7. Ky vendim hyn ne fuqi pas shprehjes se ligjshmerise nga Prefektura Vlore.

KRYETAR

ASAF STROKA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SARANDË

R E L A C I O N

mbi

VENDIMIN

“PËR BUXHETIN E VITIT 2020”

Të nderuar këshilltarë !

Buxheti i vitit 2020 që Ju paraqitet për shqyrtim e miratim është pjesë integrale e buxhetit afatmesëm 2020 -2022 , në përputhje me kërkesat e ligjit Nr 68 datë 27.04.2017 " Për financat vendore " .

Plotësimi i programeve të këtij buxheti është rezultante e një konsultimi të gjerë me komunitetin , me grupet e interesit, por edhe i një kontakti të drejtpërdrejte me problematikat në të gjithë territorin e Bashkisë .

Në këtë mënyrë vlerësojmë se buxheti që ju sjellim për miratim është i balancuar , përfshin rezervat për rritjen e të ardhurave, ekonomizon shpenzimet , mbështet shtresat sociale dhe u jep prioritet investimeve . Ai është pjesë e programit afatmesem të qeverisjes vendore të dalë nga zgjedhjet e 30 qershorit të vitit 2019 , duke ndarë nga ky program ato problematika që u vlerësuan si prioritete për t'u realizuar në vitin 2020 .

Synimi kryesor për vitin e ardhshëm është që Bashkia e Sarandës të konsolidojë gjendjen financiare duke krijuar të ardhura nëpërmjet një politike fiskale sociale, që sic jeni në dijeni pa rritur thuajse asnjë taksë apo tarifë , të ardhurat do rriten nga zgjerimi i bazës së taksapaguesve , pakësimi i ndjeshëm i subjekteve me borxhe ndaj Bashkisë e për rrjedhojë të ardhurat e vitit 2020 të rriten në masën 9% më shumë se ato që pritet të realizohen për vitin 2019 .

Burimi kryesor i mbështetjes të veprimtarisë së Bashkisë do të jenë të ardhurat e veta vendore dhe kryesisht :

- Taksa e pronës duke implementuar plotësisht sistemin PROTAX
- Tarifat e shërbimit nga familjarët duke përcaktuar objektiva konkrete për uljen e debitorëve
- Taksat dhe tarifat që do të plotësojnë burimet e Bashkisë dhe do të burojnë nga veprimtaria e aktivitetit të turizmit sic janë :
  - Të ardhurat nga veprimtaria e plazheve
  - Të ardhurat nga taksa e fjetjes në hotel
  - Të ardhurat ngas zënia e hapësirave publike

Politika fiskale e vitit 2020 do të synojë që rritjen e të ardhurave ta realizojë nëpërmjet një partneriteti reciprok me bisnesin , duke forcuar strukturën kryesore të mbledhjes së të ardhurave .

Veprimtaria e Bashkisë për vitin 2020 do të mbështetet edhe në të ardhurat që do të vijnë nga 2 transfertat nga buxheti i shtetit :

- Transferta e pakushtëzuar në shumën **129,131 mijë lekë** ,nga 125,697 mije lek në vitin 2019.
- Transferta e pakushtëzuar sektoriale me shumën **101,989 mije lek** nga 100,959 mije lek në vitin 2019.

Pra sic evidentohet të dy transfertat nga buxheti i shtetit janë në nivelin e këtij viti , fakt i cili na vë para detyrave të rëndësishme për të vlerësuar cdo burim nga të ardhurat vendore ose cdo lekë që qytetarët dhe bisneset e Sarandës do ti sjellin Bashkisë për t'ua kthyer në shërbime e investime .

Në vitin 2020 Bashkia e Sarandës nëpërmjet këtij buxheti dhe mbështetur në programin 4 vjecar të qeverisjes Vendore do të plotësojë detyrimiet ndaj shtresave sociale në nevojë duke sjellë si risi të re për këtë vit zbatimin e një projekti për një qëndër Multisociale për fëmijë në nevojë për të cilën do të investojë 5 milion lekë për rikosntruksionin e objektit per ta pershtatur per kete qellim. **Vëmendje e rëndësishme në këtë buxhet i është kushtuar pjesës së investimeve : Është treguesi që jemi konsultuar më shumë me komunitetin . Fakti që muajt e fundit kemi arritur nivele të mira në realizimin e të ardhurave dhe për pasojë do të trashëgojmë në fillimin e vitit të ardhshëm afër 1.8 miljonë euro , arritëm që të planifikojmë mbi 208 milion lekë investime, pa llogaritur rreth 39 miljonë të këij viti që do të financohen në fillim të vitit 2020 nga rreth 150 milionë që ka qënë në disa vite të fundit. Është synuar të planifikohen investime të qendrueshme, afatgjata, dhe të shpërndahen proporcionalisht në territor .**

Investim i rëndësishëm dhe i qëndrueshëm për vitin e ardhshëm do të jetë Parku në qëndër të Ksamilit, investimet për kënde sportive në shkolla ,investime për infrastrukturë e ndricim në pjesë periferike të qytetit , investime në bujqësi etj .

Shpenzimet totale që parashikon buxheti për vitin 2020 në dispozicion të Bashkisë Sarandë janë në shumën 1,294,725 mije lekë ose 4,1% më shumë se viti 2019. Parimi i planifikimit të shpenzimeve në këtë buxhet paraqitet ne relacionin e projekt-buxhetit është që cdo lekë i paguar nga taksapaguesit që zhvillojnë veprimtari në territorin e Bashkisë Sarandë të shkojë përsëri në favor të tyre si shërbim apo investim . Këtë e tregon edhe fakti që, edhe pse është rritur shpenzimi për fond page për vitin 2020 me 4,6% ai i kushtohet kryesisht zgjerimit të veprimtarisë të Bashkisë sic është rasti i marrjes nga vetë Bashkia i aktivitetit të sigurisë në Bashki apo në asete të saj nga rojet private me krijimin e struktures së saj të sigurisë së objekteve duke kursyer të ardhura e duke i kaluar ato në shërbim të qytetarëve.

Të nderuar këshilltarë !

Në reflektim për sa u shpjegua në këtë relacion dhe për sa trajtohet në mënyrë të hollësishme në pasqyrat e projketbuxhetit bashkangjitur me komentet , grafikët e sqarimet e nevojshme, shpreh bindjen se ky buxhet do të miratohet unanimisht nga Këshilli Bashkiak për ti dhënë mundësi Bashkisë që me fillimin e vitit të ardhshëm, shifrat e tij të implementohen e të nise realizimi i tij me sukses.

Duke ju falenderuar !

KRYETAR

Adrian GURMA

TREGUESIT KRYESOR TË BUXHETIT PËR VITIN 2020

Buxheti i Bashkise Sarande per vitin 2020 eshte planifikuar 1,294,725 mije leke ;

- **426,500 mije leke nga te ardhurat e veta**
- **129,131 mije leke nga transferta e pakushtezuar**
- **222,105 mije leke nga te ardhurat e paperdorura per 2019**
- *200,000 mije leke nga buxheti i shtetit per investime*
- *101,989 mije leke nga transferta e pakushtezuar sektoriale*
- *215,000 mije leke nga transferta e kushtezuar*

1. *Te ardhurat vendore*

Te ardhurat e pergjithshme perbehen prej burimeve te veta te bashkise dhe granteve qeveritare. Per vitin 2020 te Bashkise Sarande jane planifikuar **1,294,725 mije leke**. Sipas burimeve te financimit ndahen si me poshte:

- **Te ardhurat nga burimet e veta per vitin 2020 planifikohet te jene 426,500 mije lek,** me nje rrijte prej 5 % krahasuar me vitin 2019, ku perfshihen te ardhurat tatimore (nga taksat) dhe te ardhurat jotatimore (nga tarifat per sherbimet publike)

- **Te ardhura nga burime qendrore per vitin 2020 si dhe te ardhurat e paperdorura per vitin 2019 planifikohet te jene 868,215 mije lek** ku perfshihen *transferta e pakushtezuar*, *transferta sektoriale* per funksionet e deleguara si dhe *transferta e kushtezuar* e destinuar per personat me aftesi te kufizuara si edhe *financimet nga FZHR* per investime ne infrastrukturen publike vendore.

- Burimet financiare totale për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave.

Struktura dhe ecuria ne realizimin e burimeve vendore në periudhën afatmesme 2020-2022 evidenton qartësisht si, ***trendin pozitiv*** të tyre ne teresi por edhe, problematikat e luhatjet dhe paqendrueshmerite ne realizimin e planit në periudha e zëra të veçantë. Trajtimi ne periudha afatmesme te ecurise se realizimit ze per ze dhe ne total te te ardhurave ekspozon qasjen pozitive të rritjes së peshës specifike të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore në raport me peshën që zënë të ardhurat nga transfertat e buxhetit nacional. Te ardhurat vendore në vitin 2020 do të përbëjnë ***64.8 %*** të burimeve nga ***35.2 %*** që zënë te ardhurat nga transfertat nacionale , pa përfshirë transfertën sociale dhe, nga ***64.2 %*** që ato zinin në vitin 2019. Krahas qasjes pozitive nga analiza e

strukturës së të ardhurave të veta nga taksat e tarifat vendore, evidentohen prirje ***pozitive*** në dinamikën e zhvillimit të tyre.

1.1 Te ardhurat nga burimet e veta vendore, planifikimi dhe shperndarja e te cilave behet ne baze te ligjit 139/2015 "Per vetqeverisjen vendore"dhe te ligjit 68/2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore". Specifika e ketyre te ardhurave eshte se edhe nese nuk harxhohen brenda nje viti, trashegohen ne vitin tjeter fiskal. Planifikimi i te ardhurave nga taksat dhe tarifat eshte mbeshtetur ne paketen fiskale 2020 e cila permban llojin e taksave, tarifave, bazen e taksueshme, kategorite e bizneseve dhe kestet e pagesave pergjate gjithe vitit, si dhe menyren e vjeljes se tyre.

Planifikimi i te ardhurave u be ne bashkepunim me te gjitha drejtorite ne administraten e Bashkise, me Njesine administrative dhe me agjentet tatimore. Ky bashkepunim u be per te siguruar nje planifikim sa me te sakte te kategorive te taksave dhe tarifave, mbeshtetur ne nje database pothuajse te sakte te kategorive te taksueshme.

Politika e planifikimit te te ardhurave te veta 2020 ka qene, zgjerimi i bazes se taksueshme me perfshirjen e kapacitetit te plote subjekteve tatimpagues, me qellim mosrendimin e taksapaguesve te rregullt dhe duke qene te drejte sidomos per taksat qe rendojne familjaret. Ne kete menyre do te kemi nje realitet objektiv te kapacitetit te te ardhurave, duke eleminuar keshtu luhatjet e theksuara te realizimit te zerave te vecante nga viti ne vit. Nje planifikim me marzh te ulet pasaktesie do te pasohet nga nje perqindje e larte realizimi te ardhurash, e cila do te jete nje financim te sigurt te funksioneve te bashkise ne plotesimin e objektivave dhe nevojave qe ajo ka ne teresine e saj.


Tabela 1.Te ardhurat e veta te vendore

	Te ardhurat e veta	**Plan 2019**	**Plan 2020**
1	**Nga burimet e veta vendore**	**405,850**	**426,500**
-	Te ardhura tatimore-taksat	265,350	272,500
-	Te ardhura jotatimore -tarifat	140,500	154,000
2	**Te ardhura te trasheguara nga viti i meparshem**	**230,000**	**222,105**
3	**Te ardhura nga burime qendrore**	**226,656**	**231,120**
-	Transferta e pakushtezuar	125,697	129,131
-	Transferta e pakushtezuar sektoriale	100,959	101,989
	Totali	**862,506**	**879,725**

- Kontributi ne rritje e seiciles prej kategorive te te ardhurave ka bere qe edhe planifikimi te jete me i larte per vitin 2020. *Ta ardhurat nga taksat jane planifikuar 3.2* % me te larta dhe *te ardhurat nga tarifat 9.7* % me shume se ne vitin 2019 dhe ne total te ardhurat nga

burimet e vet ate bashkise jane planifikuar 5.09 % me te larta krahasimisht me vitin 2019. Peshen e rritjes ne planifikim e mbajne taksa per sherbimin hotelier dhe taksa per ndikim ne infrastrukture per ndertimet e reja.Ne grupin e tarifave planifikim ne rritje eshte bere per tarifen e pastrimit per bizneset.

Grafiku 1. Kontributi sipas kategorive ne te ardhurat ne 000/leke




Te ardhurat nga burimet e veta vendore perbejne burimin kryesor te te ardhurave te bashkise, te cilat perbehen nga taksat, tarifat dhe te ardhura te tjera. Pjesen me te madhe te tyre e zene taksat (rreth 56%). Kapaciteti i bashkise për të gjeneruar të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore, paraqet edhe performancen e sherbimeve publike si dhe investimeve kapitale ne teritorin e bashkise.

- Ne zerat e taksave dhe tarifave qe ndikojne kryesishn ne planin e te ardhurave jane taksa mbi pasurine e palujtshme me 41.4 % te totalit te taksave, si dhe tarifa e pastrimit me 52% te totalit te tarifave.

Tabela 2. Te ardhurat nga burimet vendore ne 000/leke

Nr	Te ardhura nga burimet e veta vendore	Plan 2020
1	Te ardhura nga taksat	239,000
2	Te ardhura nga taksat e ndara	33,500
3	Te ardhura nga tarifat	129,500
4	Te ardhura te tjera	24,500
	Totali	**426,500**

Grafiku 2. Struktura e perberjes te te ardhurave vendore.




Shtylla e dyte e burimeve totale te bashkise jane *te ardhurat nga grantet qeverirate* qe trajtohen ne te pakushtezuara te cilat zene rreth 35% te transfertave dhe ato te kushtezuara te cilat zene 65 % te totalit te fondeve.

Tabela 3. Te ardhurat nga burimet qendrore


Nr	**Te ardhurat nga burimet qendrore**	**Plan 2020**
1	Transferta e pakushtezuar	129,131
2	Transferta e pakushtezuar sektoriale	101,989
3	Transferta e kushtezuar	215,000
4	Grande qeveritare per investime	200,000
	Totali	**646,120**

Grafiku 3. Struktura e te ardhurave me burime nga buxheti i shtetit



Grafiku 4.

- Ndikimi ne te ardhurat e veta taksat dhe tarifat




- Baza e taksueshme per kategorine e taksave dhe tarifave vendore jane bizneset, familiaret dhe institucionet. Peshen me te madhe e mbajne familjaret te cilet perbejne rreth 83.2 % te taksapaguesve dhe me pas vjen biznesi i vogel me 16.8 % te totalit te te ardhurave. Me poshte paraqiten kategorite e taksapaguesve te ndara sipas lagjeve dhe njesive administrative.

Tabela 4. Kapaciteti i bizneseve te vegjel sipas numrit.

Kapaciteti i taksapaguesve sipas grupimeve (numri)						
Nr	**Bashkia Sarande**	**Totali**	**Familjet**	**Biznes i vogel**	**Biznes i madh**	**Institucione**
1	**NjA Sarande**	**16,166**	**13,751**	**2,073**	**326**	**18**
	Lagjia 1	**3,501**	2,688	663	146	4
	Lagjia 2	**1,732**	1,338	347	43	4
	Lagjia 3	**2,314**	1,703	574	34	6
	Lagjia 4	**4,640**	4,217	350	69	4
	Lagjia 5	**3,979**	3,805	139	35	
2	**NjA te tjera**	**2,533**	**1,892**	**622**	**19**	
	Nj.A Ksamil	**2,533**	1,892	622	21	
	TOTALI	**18,699**	**15,643**	**2,695**	**349**	**18**

Perqendrimi i bizneseve eshte kryesisht ne zonat urbane ne Sarande dhe njesine administrative Ksamil. Vecoria e bizneseve qe operojne ne bashki eshte se nje perqindje e larte e tyre jane active vetem ne sezonin turistik dhe kjo ben qe te jete e veshtire identifikimi I aktivitetit te tyre dhe shmangia e abuzimeve me te qenit "aktiv" te statusit te biznesit.

Grafiku 5.Struktura e perberjes se bazes se taksueshme




-Ne tabelen e meposhtme paraqitet numri i bizneseve sipas objektit aktivitetit qe kryejne. Pjesa dominuese e bizneseve ne Sarande jane me objektin "tregeti dhe sherbime", "ambulantet", Profesionet e lira" dhe ne fund "prodhuesit" me perqindjen me te ulet te totalit te bizneseve.

Tabela 5 Kapaciteti i bizneseve te vegjel sipas natyres

Kapaciteti i bizneseve te vegjel sipas natyres (numri)						
			Nga kjo			
Nr	Bashkia Sarande	biznesi i vogel	Njesi tregetare dhe sherbimi	Njesi prodhimi	Profesione te lira	Ambulante
1	**NjA sarande**	**2013**	**1481**	**84**	**113**	**335**
	Lagjia 1	665	240	17	77	329
	Lagjia 2	347	315	15	17	
	Lagjia 3	546	481	11	34	45
	Lagjia 4	350	326	17	7	
	Lagjia 5	139	125	13	1	
2	**Nj.A te tjera**	**622**	**565**	**35**	**4**	**18**
	Nj.A Ksamil	622	565	35	4	18
	TOTALI	**2695**	**2055**	**108**	**140**	**392**

Grafiku 6. Struktura perberese e bizneseve te vegjel sipas natyres.



1.1.1 Te ardhurat nga taksat:

Ligji nr. 9632, date 30.10.2006 " per sistemin e taksave vendore", me ndryshimet perkatese perben ligjin baze i cili percakton rregullat per ushtrimin e te drejtave dhe detyrave te njesise te qeverisjes vendore ne drejtim te taksave vendore, mbledhjes dhe administrimit te tyre.

Paketa fiskale e Bashkise Sarande ne perfshirje edhe me grupet e interest pasqyron disa politika per ndryshimin e nje numur te kufizuar nivelesh brenda kornizave ligjore, me qellim tedencen e balancimit , dhe afrimit te realitetit te marrjes se sherbimit me koston e saj.
Per vitin 2020 te ardhurat nga taksat perbejne rreth 56% te te ardhurave nga burimet e veta te bashkise.
Pjese e rendesishme ne kete kategori te taksave vendore jane te ardhurat nga taksat mbi pasurine e palujtshme me rreth 42 %, dhe me pas vine taksat mbi zenien e hapesirave publike me rreth 17 %, taksa mbi ndikimin ne infrastrukture me 25 % , taksa e fjetjes ne hotel me 10 % dhe te tjera me 6 % te totalit te taksave.

Te ardhurat nga taksat mbi pasusine e palujtshme perbehen nga; .

- Taksa mbi ndertesat (mbi ndertesat e banimit dhe mbi ndertesat e tjera) me 90% te totalit te takses.
- Taksa mbi token bujqesore me 6.6%.
- Taksa mbi truallin me 3.4% .

Kjo takse relativisht e re ne strukturen e taksave, dhe përbën një burim të qenësishëm dhe të qëndrueshëm të ardhurash për buxhetin vendor dhe ne buxhetin e vitit 2020 eshte planifikuar **99,000 mije leke**, dhe niveli i takses nuk ka ndryshuar nga nje vit me pare. Në nivel bashkie, rreth 42% e të ardhurave nga taksa për pasuritë e paluajtshme realizohet në territorin e bashkisë si rezultat i përqendrimit të një numri të lartë banesash në këtë territor. Edhe ne vazhdimesi do te punohet per zgjerimin i bazes se taksueshme si burimi me i rendesishem dhe i qendrueshem per te ardhurat vendore nepermjet:

- Metodologjisë së re të taksimit mbi bazën e vlerës së tregut të ndërtesës ,
- Përmirësimit të normës së mbledhjes së të ardhurave.
- Aplikimit te kadrastes fiskale.

- *Te ardhurat nga taksa mbi ndertesat*

E pare nga pikpamja e struktures taksa mbi ndertesat ze peshen me te madhe ne kete kategori taksash reth 91 % te taksat mbi pasurine e paluajtshme.Planifikimi i te ardhurave prej 90,000 mije LEK, per vitin 2020 eshte bere duke u bazuar ne pandryshiueshmerine e nivelit te kesaj takse per kete vit. Siperfaqja e ndertesave te banimit qe do te taksohet parashikohet rreth 1,396,896 m². Taksa e nderteses per biznese ka per baze ndertesat ne meter katror te ndertesave qe perdoren per biznese. Per vitin 2020 do te taksohen rreth 2,689 ndertesa biznesi me rreth 298,719 m², te dhena keto te marra nga verifikimet ne terren dhe vetedeklarimet dhe qe me kalimin e kohes do te kete korrektime me kadrasten fiskale.Ne ate moment do te behet edhe ndryshimi ne rritje ne planifikimin e te ardhurave. Përdorimi si agjent tatimor i ndërmarrjeve të UK-ve duket të ketë dhënë rezultate pozitive në periudhën e konsideruar dhe pritet te japi rezultate edhe me pozitive ne te ardhmen.

- *Te ardhurat nga taksa mbi token bujqesore*.

Te ardhurat *nga taksa mbi token bujqesore* zene nje vend te moderuar me vetem 6 % te kesaj kategorie takse. Kjo takse administrohet nga bashkia ka per baze siperfaqen e tokes bujqesore , ne hektar ne pronesi ose ne perdorim nga fermeret.

Per vitin 2020 planifikimin i te ardhurave me vlere 6,000 mije lek eshte bere duke u bazuar ne kapacietin aktual te siperfaqeve te tokave bujqesore ne pronesi te fermereve ne territorin e bashkise dhe njesise administrative. Kapaciteti aktual total i siperfaqes se taksueshme te tokes bujqesore eshte rreth 1,603 ha. Fakti qe jo e gjithe siperfaqja eshte e shfrytezuar dhe e zhvilluar e ben jo pak te veshtire mbledhjen e kesaj takse e cila ne 40% te vleres se saj duhet te kthehet ne investim ne infrastrukturen bujqesore.

Grafiku 7. Taksa mbi pasurine e palujtshme.



- *Te ardhurat nga taksa e truallit*:

Te ardhurat nga *taksa e truallit* eshte relativisht nje takse e re, e aplikueshme per trojet me destinacion ndertimin dhe zhvillimin urban, me pronar individin. Kjo takse u vendos per here te pare ne paketen fiskale 2016 dhe me nje perllogaritje fillestare eshte planifikuar **3,000 mije lek**. Realizimi i te ardhurave nga kjo takse eshte ne nivele te uleta , por pavaresisht kesaj planifikimi per vitin 2020 eshte bere ne baze te siperfaqeve truall te pazhvilluara aktualisht ne vleren **6,000 mije** leke.

Taksa per zenien e hapesirave publike.

Te ardhurat nga *taksa per zenien e hapesirave publike* perben nje nga te ardhurat me te konsiderueshme nga taksat duke kontribuar me 40% te totalit. Planifikimi per vitin 2020 eshte ne te njejtat nivele te nje viti me pare ne vleren **40,000 mije leke.** Kjo takse ka per baze hapesirat publike te cilat bashkia i jep me qera tek perdoruesit kryesisht per periudha sezonale. Baze per llogaritjene kesaj takse eshte siperfaqja e marre ne perdorim ne menyre kontraktuale. Perqindjen me te madhe te kesaj takse e zene taksa mbi siperfaqet e plazheve te dhena me qera te cilat perbejne rreth 66 % totalit me rreth 33.600 m² plazhe te kontraktuarame perdoruesit nder vite. Pjesa tjeter eshte siperfaqe publike kryesisht ne bulevard por edhe zona te tjera te bashkise te cilat edhe keto merren me qera ne perdorim nga bizneset dhe taksohen ne baze te ligjit ne fuqi.

Nje rrijte e lehte llogaritet nga shtimi i numrit te diteve te llogaritura si "sezon turistik" per perllogaritjen e detyrimit per hapesirat e plazheve te marra me qera me 15 dite. Por kjo shume nga ana tjeter do te kompesoje te ardhurat nga marrja me qera nga ana e bizneseve qe operojne ne bulevard ne menyre te pakontrolluar vitet e fundit, e diktuar kjo edhe nga projekti qe pritet te zbatohet ne shetitoren e qytetit.

Taksa e fjetjes ne hotel.

Te ardhurat nga kjo takse administrohet nga bashkia dhe ka nje kontribut te konsiderueshem ne te ardhurat nga taksat e bashkise me 10% te strukturen se saj. Ne buxhetin e vitit 2020 eshte planifikuar **24,000 mije leke** me nje rritje prej **1,000 mije leke** ne krahasim me vitin 2019, duke u mbeshtetur ne nje administrim me efektiv nga ana e bashkise duke shmangur abuzimet dhe informalitetin e mundshem nga ana e biznesit. Baza e takses se fjetjes ne hotel eshte numri i neteve te qendruara ne hotel per person dhe percaktohet me ligj. Taksa shenohet ne fature dhe mbi cminin e fjetjes. Bashkia e Sarandes perfshire edhe Njesine Administrative te Ksamilit ka nje kapacitet prej rreth 3,600 dhomash ne shfrytezim me rreth 7,850 shterter. Faturimi i detyrimit behet ne baze te ligjit "per taksat vendore i ndryshuar", ne baze te vetedeklarimit nga ana e subjekteve ne cdo date 5 te muajit pasardhes, ne te kundert, administrata vendore e tatim taksave e eshte detyruar te beje faturim ne baze te te dhenave te verifikueshme edhe ne terren me kapacitet te plote netesh dhe dhomash.

Planifikimi i te ardhurave eshte bere duke parashikuar kapacitetet, numrin e njesive dhe periudhen e shfrytezimit dhe me koeficientin e shfrytezimit ne baze te frekuentimit te teresise te hotelerise.

Te ardhura nga Taksa e ndikimit ne infrastrukture.

Të ardhurat nga *taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja* vijojnë të përfaqësojnë një burim të rëndësishëm dhe qenësishëm në buxhetin vendor. Per vitin 2020 të ardhurat nga kjo taksë përfaqësujne rreth 25 % ndaj totalit të të ardhurave nga taksat vendore dhe rreth 14 % ndaj totalit të të ardhurave nga burimet e veta vendore. Këta dy tregues sinjalizojnë për varësi të lartë të buxhetit vendor nga kjo taksë dhe rreziqe të shtuara per vete natyrës ciklike të saj. Gjithashtu, mund të ndodhë që bashkia të zhvendosin preferencat për likuiditet në terma afatshkurtër, në kurriz të zhvillimit të qëndrueshëm afatgjatë. Sfida e politikave te bashkise do te jete qe hapesiren e kesaj takse ta konsideroje si nje te ardhur te "perkohshme" me qellim qe te ndikoje e saj te sa me pak ne raport me zhvillimin e ekonomise, duke mbajtur ne vemendje kategorite e qendrushme te taksave .

Zbatimi i Planeve të Përgjithshme Vendore (PPV) nëpërmjet lejeve të reja të ndërtimit, nga një anë, ndikon pozitivisht në rritjen e të ardhurave nga TNI për bashkine, nga ana tjetër, i vendos ato në një pozicion sfidues *për ofrimin e infrastrukturave të nevojshme publike*, *të cilat gjithashtu kërkojnë financime si në zhvillim fillestar ashtu dhe në mirëmbajtje të vazhdueshme*.

Taksa e ndikimit ne infrastrukture per ndertimet e reja administrohet nga bashkia dhe bazuar ne ligjin 9632 "Per sistemin e taksave vendore" percaktohet ndermjet kufinjve 4-8 % te cmimit te shitjes per qellime banimi apo sherbimi nga shoqerite e ndertimit te cilat nuk perdoren per qellime turizmi, industrie apo sherbim publik. Per ndertimet e tjera eshte 3% e vleres se investimit qe kerkohet te kryhet kurse ndertesat ne process legalizimi llogaritet 0.5% e vleres se investimit. Plani per vitin 2020 prej **60,000 mij lek** bazohet mbi trendin ne rritje te te ardhurave per vitet e

fundit parashikimin e lejeve per ndertimet e reja dhe te ardhurat e detyrimeve te atyre ne process legalizimi. Per vitin 2020 pritet te kete kerkesa te reja per zhvillim te hapesirave per ndertim.

Te ardhurat nga Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme.

Kjo takse administrohet nga Agjensia Shteterore e Kadastres. Taksa me nivelet e vendosura ne Ligjin Nr. 9632 paguhet para kryerjes se rregjistrimit qe kalon te drejten e pronesise mbi pasurine e paluajtshmedhe vendoset per ndertesat dhe te gjitha pasurite nga ASHK, te cilat ne rolin e agjentit tatimor perfitojne 3% se shumes se arketuar.

Planifikimi prej **8,500 mije lek** eshte bere duke pasur parasysh ecurine e realizimit te kesaj takse vit pas viti.

Te ardhurat nga Taksa e regjistrimit te mjeteve te perdorura

Bazuar ne ligjin nr. 997 dt.28.07.2008 "Per taksat kombetare" te ndryshuar percaktohet administrimi i takses ku pas arketimit nga Drejtoria e Pergjithshme e Transporteve Rugore ne rolin e agjentit tatimor, dhe pasi arketon detyrimin nga pronari i mjetit ne vleren e takses per automjetit, ne baze te numrit te mjeteve kalon 18% te shumes ne llogari te bashkise Sarande.

Planifikimi i pandryshuar prej **19,000 mije lek** behet me te dhenat e marra nga agjenti tatimor i cili bazohet ne te dhenat e regjistruara per nivelet e taksave dhe numrin e automjeteve.


Te ardhurat nga Taksa e tabeles

Taksa e tabeles aplikohet per tre lloje tabelash, te percaktuara sipas qellimit te perdorimit dhe nga menyra e vendosjes se tyre:

- Tabela per qellime identifikimi, *qe jane* brenda territorit ose ne trup te biznesit.
- Tabela per qellime reklamimi, *qe nuk jane* brenda territorit ose ne trup te biznesit.
- Tabela per qellime ekspozimi, me karakter te perkohshem.

E ardhura nga kjo takse parashikohet te jete e pandryshuar per vitin 2020 ne shumen **3,000 mije lek,** bazuar ne numrin e tabelave , siperfaqen dhe kategorinee tyre.

Grafiku 8. *Ndikimi i cdo takse ne strukturen e pergjithshme ne %.*



1.1.2 Te ardhtrat nga Tarifat vendore:


Sipas ligjit *139/2015 "Per veteqeverisjen Vendore*" Bashkite krijojne te ardhura nga tarifat vendore per sherbimet publike qe ato ofrojne; te drejten e perdorimit te pronave publike, dhenien e lishensave, lejeve, autorizimeve dhe leshimeve te dokumentave te tjera per te cilat kane autoritet te plote. Bashkite vendosin vete per nivelin, menyren e mbledhjes dhe te administrimit te tarifave vendore ne perputhje me politikat dhe parimet e pergjithshme te percaktuara ne ligj.

***Tabelë 6**. Të ardhura nga tarifa vendore sipas kategorive (në 000/ lekë)*

	ne vlere	*pesha ndaj totalit*
Tarifë pastrimi dhe menaxhim mbetjesh	68,000	52.1%
Tarifa për ndriçimin publik	15,000	11.5%
Tarifa për gjelbërimin	7,000	5.4%
Të ardhura nga tarifat e shërbimeve	40,500	31%

Të ardhurat nga tarifat vendore përfaqësojnë një burim të rëndësishëm të ardhurash në buxhetin vendor. Ndaj totalit të të ardhurave vendore, të ardhurat nga tarifat zënë një peshë prej 30 %, dhe përfaqësojnë një kategori të ardhurash mbi të cilat bashkia kanë të drejta të plota vendimmarrje. Në përgjithësi, të ardhurat nga tarifat vendore paraqesin prirje rritëse nga viti në vit, diktuar deri diku edhe nga performanca lidhur me aplikimin e perdorimit te UK si agjentë tatimorë.

Grafiku 9 . *Performanca e zërave kryesorë të tarifave vendore*



Te ardhurat nga tarifat e sherbimeve publike

Planifikimi ne total per vitin 2020 nga tarifat vendore eshte ne vleren **130,500 mije leke** me nje rritje prej 4,500 mije leke nga nje vit me pare.

Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve publike (menaxhimi i mbetjeve, ndriçimi dhe gjelbërimi, ujitja dhe kullimi) jane planifikuar ne vlerën prej rreth **90,000 mije lekë**, në rritje prej 2,000 mije leke nga nje vit me pare. Rreth 52.1% e të ardhurave nga tarifat për shërbimet publike jane planifikuar nga tarifa e pastrimit dhe perpunimit te mbetjeve. Të ardhurat nga tarifa e ndriçimit publik eshte planifikuar 15,000 mije leke me 11.4% ndaj totalit nga tarifat e shërbimeve publike. Tarifa e gjelberimit eshte planifikuar ne shumen 7,000 mije leke me nje rritje 2,000 mije leke dhe me nje peshe prej 5.3% ndaj totalit te sherbimeve publike.

Tarifat per sherbimet administrative jane planifikuar 36,500 mije leke me nje rritje prej 8,500 mije leke dhe me nje peshte prej 27.9% ne totalin e sherbimeve publike. Planifikimi i tarifave eshte ne rritje , pasi edhe sasia e sherbimeve si dhe cilesia e tyre eshte ne rritje si per familjaret ashtu edhe per bizneset.

Te ardhurat nga tarifat e sherbimeve publike *per pastrimin e largimin e mbetjeve gjelberimin dhe ndricimin publik* shlyhen ne baze mujore se bashku me faturen e sherbimit te furnizimit me uje tek Ndermarja e Ujesjelles Kanalizimeve sh.a Sarande , ne cilesin e agjentit tatimor.

Tarifa e parkimit per mjetet e lishensuara dhe vendparkimet publike eshte planifikuar ne te njejten vlere me nje vit me pare **2,500 mije leke** me nje peshe prej 6.8% ne totalin e sherbimeve administrative. Vlera per nje parkim te rezervuar vjetore eshte e miratuar ne paketen fiskale 2020.

1.1.3 Te ardhura te tjera.

Te ardhura nga dhenia me qera e aseteve ne pronesi te Bashkise.

Ne buxhetin 2020 jane planifikuar ne te njejtat shuma me nje vit me pare **me 21,500 mije leke.**

Peshen kryesore ne kete kategori te ardhurash e ze *qerate nga asetet ne pronesi te Bashkise me 41.8* % te totalit. Bazuar ne VKM nr 529/2014, date" Per percaktimin e kritereve, te procedures dhe menyres se dhenies me qera, enfiteoze apo kontratat e tjera te pasurise shteterore" i ndryshuar.Pasurite qe jepen me qera jane ndertesat,trualli i lire.Perllogaritja e ketij parashikimi behet mbi kontratat e lidhura ndermjet bashkise dhe qeramarresve.

Te ardhura nga financim projektesh me BE

Per vitin aktual jane bere nje sere aplikimesh me projekte te ndryshme kryesisht ne fushen e turizmit , ne kuader te programit IPA,me financim nga BE. Bashkia eshte partnere ne dy projekte me tituj "HOREKA" dhe "ITERNET OF BEANS" prej te cilit priten financim **4,000 mije lek** parafinancime per vitin 2020.

1.2 Te ardhura nga Buxheti i Shtetit

1.2.1. Të ardhurat nga transferta e pakushtezuar eshte e ardhura nga qeverisja qendrore per qeverisjen lokale, per te financuar funksione te qeverisjes vendore te cilat nuk mund te mbulohen

nga te ardhurat e veta. Sipas ndarjes se re teritoriale formula per ndarjen e kesaj transferte eshte bazuar tek popullsia relative. Per vitin 2020 eshte miratuar transferta e pakushtezuar **129,131 mije lek** per Bashkine e Sarandes me nje rritje prej 2.7 % prej vitit 2019.

1.2.2. Te ardhurat nga transferta e kushtezuar sektoriale eshte nje e ardhur nga buxheti i shtetit per te financuar funksionet e deleguara te njesive te varesi te bashkise qysh prej bashkimit territorial ne vitin 2015. Kjo transferte financon kryesisht shpenzimet per pagat dhe sigurimet shoqerore te ketyre institucioneve.

Konviktet e arsimit parauniversitar.Per vitin 2020 nga buzheti i shtetit eshte planifikuar per shpenzimet per pagat, sigurimet shoqerore dhe shpenzimet operative dhe investime ne vleren **18,371 mije leke**. Standartet dhe kriteret e sherbimit do te kryhen ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi.

*Sherbimi per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimi (PMNZSH).*Ne transferten e planifikuar per vitin 2020, jane fondet per PMNZSH. Ne kete fond bejne pjese fondi i pagave, sigurimeve shoqerore si dhe fondi per shpenzimet operative.Standartet e ofrimit te sherbimeve do te behen ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi.Shuma e planifikuar per kete funksion eshte **17,743 mije lek**.Nga buxheti I bashkise me te ardhurat e veta mbulohen edhe nevoja shtese te domosdoshme per kete sector.

Personeli mesimor dhe jomesimor ne arsimin parashkollor dhe personeli jomesimor ne arsimin parauniversitar.Ne transferten sektoriale te vitit 2020,jane fondet per personelin arsimor dhe ate ndihmes per arsimin parashkollor si dhe per personelin ndihmes per arsimin parauniversitar me perjashtim te arsimit te mesem profesional.Per per vitin 2020 eshte alokuar nje fond prej **57,537 mije leke**. Fondet e alokuara per kete program jane te destinuara per pagat dhe sigurimet shoqerore.

Administrimi i pyjeve

Ne transferten e pakushtezuar sektoriale te vitit 2020, jane fondet per Sherbimin pyjor. Ne kete fond bejne pjese fondi i pagave, sig. shoqerore si dhe fondi per shpenzimet operative.Standartet e ofrimit te sherbimeve do te behen ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi.Shuma e planifikuar per kete funksion eshte **2,372 mije lek.**

Ujitja dhe Kullimi

Ne transferten e pakushtezuar sektoriale te vitit 2020, perfshihen edhe fondet per Ujitjen dhe Kullimin. Ne kete fond bejne pjese fondi i pagave, sig. shoqerore si dhe fondi per shpenzimet operative.Standartet e ofrimit te sherbimeve do te behen ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi.Shuma e planifikuar per kete funksion eshte **5,966 mije lek**

1.2.3 -Transferta e Kushtezuar

Transferta e kushtezuar perbehet prej;

- *Funksionit te deleguar* per *sherbimin e Gjendjescivile*, **3,721 mije leke**, *Qendres Kombetare te Biznesit* **1,930 mije lek**, fondet per *mbeshtetje ekonomike per familjet ne nevoje* **17,000 leke** dhe *personat me aftesi te kufizuar* **198,000 mije lek**. .

- *Financimet e deleguara per investime*.

Bashkia ka perfituar edhe perfiton fonde nga buxheti i shtetit nepermjet instrumentit te saj, Fondit Shqiptar te Zhvillimit per projekteve te aplikuara nga ana e bashkise sipas prioriteteve. Ne pritje per financim te projekteve te nevojshme nga bashkia, por edhe duke marre ne konsiderate situaten emergjente ne te cilen ndodhet vendi, per vitin 2020 jane parashikuar 200,000 mije leke per investime publike.

2. Shpenzimet vendore

Përdorimi i burimeve financiare në dispozicion, përbën shtyllen tjetër të rëndësishme në menaxhimin financiar publik vendor. Per vitin 2020 ne buxhetin e Bashkia Sarande kanalizon rreth 67% të burimeve financiare totale për mbulimin e shpenzimeve korrente dhe rreth 34% për shpenzime kapitale.

2.1 Shpenzimet sipas burimit të financimit

Planifikimi i shpenzimeve totale mundohet të paraqesë një panoramë të përgjithshme mbi mënyrën se si do te shpenzohen fondet në dispozicion të bashkise per vitin 2020: *sipas burimit të financimit* dhe kryqëzuar me *kategorizimin sipas natyrës ekonomike* (paga dhe sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime) dhe *sipas funksioneve të programeve te qeverisjes lokale* (arsim, sherbime publike, kulture, etj.).

Per vitin 2020 ne total, fondet e planifikuara ne dispozicion te funksionimit te bashkise *jane* **1,294,725 mije leke**, shifer kjo rreth 4.2% më e lartë se ajo planifikuar ne buxhetin e nje viti me pare. *Përfshire te ardhurat e trasheguara*, shpenzimet e planifikuara nga te ardhurat e veta dhe transfertat e pakushtezuara per vitin 2020 jane ne rritje me rreth **27,220 mije leke**, ose 4 % më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. *Shpenzimet ne total perfshire edhe fondet pakushtezuara* jane planifikuar **52,219 mije leke** me shume se nje vit me pare me nje rritje prej 5%, . Shpenzimet e planifikuara *me fondet e kushtezuara* jane planifikuar **35,000 mije leke** me shume me 9.2% krahasuar me nje vit me pare.


Totali i shpenzimeve publike për vitin 2020 nga te ardhurat vendore *,transferten e pakushtezuar dhe transferta e pakushtezuar sektoriale* është planifikuar të jetë **879,725 mije leke** me *nje rritje prej 27,220 mije leke krahasuar me* nje vit me pare dhe me rreth 3%. Rritja e fondeve ne dispozicion te planifikimit te fondeve per shpenzime dhe investime ne buxhetin e ketij viti vjen si rezultat i rritjes ne planifikim te te ardhurave te tarifave dhe taksave me 5% si dhe rritja e transfertes se pakushtezuar me 3% . Planifimimi ne rritje eshte fondi per investimet kapitale ne vleren 14,404 mije leke me rreth 6.1 % dhe ne vleren 16,214 ne shpenzimet per pagat me rreth 5.6% .

Grafik 10. *Shpenzimet sipas dhe burimit të financimit ne 000/leke*.



Shpenzimet korrente për vitin 2020 janë planifikuar te mbulohen 82.5% nga te ardhurat e veta dhe ne masen 17.5% nga transferta e pakushtezuar,shpenzimet kapitale me te ardhurat e veta jane parashikuar (edhe ne zbatim te ligjit 139/2015 "per financat vendore") 40% nga transferta e kushtezuar dhe 60% nga te ardhurat e veta ndersa ne total shpenzimet kapitale jane parashikohuar me rreth 51% nga te ardhurat e veta dhe ne masen 49% nga burimet e kushtezuara (perfshire ketu fondet nga FZHR) .


Grafiku 11. *Shpenzimet sipas funksioneve te qeverisjes vendore*



Shpenzimet ne total per vitin 2020 jane planifikuar ne vleren **1,294,725 mije leke** me nje rritje ne terma te pergjithshem prej 4.1% **.**

Sipas natyres ekonomike te shpenzimeve planifikimi *per shpenzime per fond pagash* ne total jane planifikuar ne vleren 249,152 mije leke, me nje rritje prej 5.9%, *per sigurimet shoqerore jane* planifikuar ne vleren 41,490 mije leke. Ne zerin e *shpenzimeve operative* shuma e parashikuar per vitin 2020 eshte 293,692 mije leke me nje ulje ne terma vjetore me 9.7 % , *fond i vecante* eshte planifikuar ne shumen 2,362 mije leke , *investime kapitale planifikimi* per vitin buxhetor eshte ne vleren 451,4990 mije leke, *transfertat te brendshme* jane parashikuar ne shumen 41,500 leke me nje rritje prej 18% dhe transfertat per familjet dhe individet jane parashikuar 415,000 mije leke.

Grafik 12. *Shpenzimet me fonde të veta dhe transferta sipas natyrës ekonomike.*



2.1.1 Shpenzimet e kryera me fonde nga burimet e veta dhe transferta e pakushtezuar

Planifikimi i shpenzimeve per vitin 2020 nga te ardhurat e veta, (perfshire edhe transferten e pakushtezuar) eshte ne vleren **777,736 mije leke**. Krahasimisht me vitin 2019, shpenzimet e plafifikuara me fondet e veta jane ne rritje me nje vlere ne terma vjetor dhe 3.5% dhe ne vlere prej 26,189 mije leke. *Shpenzimet per paga dhe sigurime shoqerore* jane parashikuar ne vleren 207,717 mije leke , *shpenzimet operative* jane parashikuar ne vleren 279,795 mije leke dhe *fondet per investimet nga te ardhurat e veta* (perfshire ato te palikujduara nga viti 2019) jane planifikuar ne vleren 247,724 mije leke dhe planifikimi per *transferta per financime* nga te ardhurat e veta jane planifikuar ne vleren 41,500 mije leke.

- ***Shpenzimet per te gjitha programet dhe natyres ekonomike me fondet e veta .***

Planifikimi i fondit per zerin paga dhe sigurime shoqerore me te ardhurat e veta eshte ne nivelin e **207,717 mije leke** me nje rritje prej **15,393 mije leke** me nje zgjerim te fondit te pagave prej prej 8 % ne terma vjetore. Ne kete fond perfshihet pagesa e punonjesve te administrates se bashkise dhe ndermarrjeve ne varesi te saj. Ne shtesen e fondit te pagave eshte parashikuar rritja e nje numri punonjesish mbeshtetes te funksioneve te bashkise (roje institucionesh ne varesi te bashkise), sherbime keto ne vitet e meparshme kane qene te kontraktuara me te trete. Me ndryshimin e menyres se funksionimit te ketij sektori, do te kemi rritje te numrit te punonjesve dhe kursim fondesh publike ne zerin e shpenzimeve operative. Shpenzimet e personelit vijojne te jene njejta pa nje prirje rritese, pasi nevoja per rritje te numrit te punonjesve e diktuar nga faktore te ndryshem *ndikon ne shuarjen e efektit te rritjes se nivelit te pagave*.

Shpenzimet operative dhe të tjera jane planifikuar ne nivelin **279,795 mije leke** me nje ulje prej **10,108** mije leke e krahasuar me nje vit me pare.
Ne zerin e "*mallra dhe sherbime per administraten*" kemi nje tkurrje ne terma vjetore prej **3,398 mije leke**. Ndryshim ka ne planifikimin e zerit *"shpenzime per sigurimin dhe ruajtjen*" me **5,200 mije leke** te cilat nje pjese kaluan per fond pagash dhe nje pjese per fondin e emergjencave civile. Per vitin 2020 ky ze shpenzimesh eshte planifikuar ne vleren **72,270 mije leke**.

Programi i zhvillimit ekonomik dhe turizmit. Per vete natyren qe ka qyteti i Sarandes turizmi si aktivitet ndersektorial, eshte i lidhur me shume aktivitete ekonomike dhe ka nje ndikim te jashtzakonshem pothuajse ne te gjithe sektoret e ekonomise, sidomos ne biznesin e hotelerise, njesite tregetare, njesite prodhuese, profesionet e lira deri tek turizmi familjar, bizneset e sezonale etj. Ai udheheq zhvillimin ekonomik te qytetit pasi kontriubon direkt ne krijimin e vendeve te punes, zhvillim lokal dhe urban. Eshte planifikuar per tu buxhetuar ne shumen 9,250 mije leke per vitin 2020. Ne kete shume perfshihen edhe *disa projekte dhe aktivitete te pervitshme* te cilat kanalizohen ne shumen 6,750 mije leke. Pjesa tjeter e fondit do te perdoret sipas vleresimeve qe do te kete keshilli artistik ne mbledhjet e tij pergjate vitit buxhetor. *Industria e Turizmit* te jete shtylla kryesore e ekonomise per te gjithe territorin e saj, ne te gjithe muajt e vitit dhe nepermjet politikave te promovimit aktiv , turizmi te kthehet ne nje mjet integrimi te territoreve me pak te zhvilluara ne menyre qe te gjitha resurset e bashkise se madhe te jene ne funksion te zhvillimit ekonomik dhe mirqenies se popullsise. Synimi do te jete nxitja e nje zhvillimi te qendrushem, te ekuilibruar ekonomik nepermjet politikave te bashkepunimit, edhe me sektorin privat si elementi me i rendesishem ne mardhenien me frekuentuesit e bregdetit te Sarandes dhe Ksamilit. Nepermjet botimeve te guidave turistike, qendrave te informacionit ne sezonin e veres, hartave turistike, publikimit ne faqen web te Bashkise Sarande, organizimi i panaireve me pjesemarrjen e bizneseve qe operojne ne territorin e Sarandes, organizimi i nje sere eventesh kulturore dhe artistike pergjate vitit te pasqyruara ne buxhet, Bashkia eshte ne mbeshtetje te turizmit pergjate gjithe vitit.
Ne zerin "*fatura te prapambetura*" krahasimisht me nje vit me pare eshte planifikuar 10,000 mije leke me pak ne shumen 25,000 mije leke. Gjate ketij viti eshte bere shlyerja e rregullt e faturave te palikujduara duke bere qe stoku i detyrimit ndaj te treteve te jete me i ulet ne kete shume perfshihen edhe faturat e krijuara nga efekti i limitimit te buxhetit ne 15 dhjetor .

Ne zerin "*agjenti tatimor*" ku perfshihet detyrimi kontraktual i perqindjes se detyrimit te shumes se arketuar nga UK per dertyrimet e taksat dhe tarifat ndaj abonenteve eshte rritur me 3,000 mij leke, si efekt i *rritjes se arketimit te takses se nderteses* dhe eshte planifikuar ne vleren 5,000 mije leke.
Ne planifikimin e "*Investimeve te palikujduara"* eshte konsideruar shuma e faturave, investime ne proces, qe do te krijohet nga limitimi i fondit ne dispozicion te buxhetit te bashkise nga MF dhe per kete vit eshte planifikuar me 39,000 mije lek me pak se nje vit me pare me 18,000 mije leke.

Fondi i *emergjencave civile* per kete vit ne buxhet eshte planifikuar me nje rritje prej 4,000 mije leke ne 44% me shume , ne vleren 9,000 mije leke, ndikuar edhe nga situatat dhe ngjarjet e fundit ne vendin tone. Me shtimin e kopetencave, transferimin e funksioneve dhe zgjerimin e territorit u krijua nje strukture per emergjencat civile e cila funksionon per rastet e emergjencave, kryesisht ne periudhen e sezonit turistik, per mbrojtjen e territorit nga zjarret, per perballimin e situatave evakuese, mobilizimi i komunitetit, sensibilizimi i tij, krijimi i grupeve vullnetare me qellim permiresimin e sigurise publike, te rritjes se sigurise se jetes, mbrojtjes se prones se qytetareve, bizneseve, aseteve administrative, pasurive natyrore dhe ambjenteve te ndryshme publike.

Vendimet gjyqesore gjithashtu jane nje fond qe rendojne cdo vit buxhetin e bashkise me rreth 10,000 mije leke per shlyerjen e vendimeve kryesisht te mbartura nder vite ne disfavorin e bashkise.
Ne buxhetin e vitit 2020 ne *kategorine e transfertave* eshte planifikuar nje fond ne rritje prej 5,500 mije lek per financimin *e Klubit te futbollit "Butrinti*". Prej disa vitesh ne planifikimin e fondit per mbeshtetje financiare te ketij klubi nuk eshte marre ne konsiderate "kostot" reale te funksionimit ne teresine e tij duke bere qe vit pas viti te krijohet nje stok detyrimesh te palikujduara dhe ka pamundesuar funksionimin e tij me kete fond. Fakti qe kontratat e lidhura me futbollistet nga ana e presidentit te klubit dhe kalendarit te veprimtarise te ketij klubi nuk perkonin me fondin e akorduar, prandaj shtimi i planifikimit ne buxhet eshte i pashmangshem per normalizimin e funksionimit te gjithe situates.
Mbeshtetje sociale me te ardhurat e bashkise eshte planifikuar ne shumen 5,000 mije leke e njejte me nje vit me pare. Me kete fond ndihmohen familjet ne nevoje qe perjashtohen nga bllokskema e ndihmes ekonomike, por edhe familje ne nevoja te ndryshme bazuar ne raportet e mbajtura nga specialistet.
Planifikimi i detyrueshem per *fondin rezerve dhe fondin e kontigjences* jane parashikuar ne te njejtat nivele ten nje viti me pare, perkatesisht 2,000 mije leke dhe 3,000 mije leke.
Fondi *per keshillin e qarkut* eshte planifikuar 2,000 mije leke ne buxhet, i njejte me nje vit me pare.

Shpenzimet per Mallra dhe Sherbime ne menyre analitike per Buxhetin 2020

Shpenzimet per energjine elektrike. Ne buxhetin e vitit 2020 jane planifikuar shpenzimet per energjine elektrike ne vleren *46,245 mije leke* me rreth 15 % te totalit te shpenzimeve operative, dhe me nje trend rritje nga viti ne vit.Nga kjo vlere kanalizohet per ndricim publik ne gjithe territorin e bashkise vlera prej *35,000 mije leke* dhe pjesa tjeter planifikohet per te mbuluar shpenzimetper ngrohje, gatim dhe ndricim ne kopeshte dhe shkolla , ne vleren *11,245 mije leke***.** Planifikimi i ketyre fondeve behet duke u bazuar ne konsumet faktike te nje viti me pare.

Bashkia Sarande ne gjithe territorin e saj ka rreth 162 kontrata me OSHEE , dhe ky numur ne rritje per vete faktin e shtimit te linjave te reja te ndricimit publik sidomos ne zonat periferike, te cilat shoqerohen me kontrata te reja dhe fatura me te larta energjie.

Furnizimi me uje, gjithashtu eshte nje shume e planifukuar ne buxhet si detyrim ndaj UK sh.a i kontraktuar per furnizimin me uje te hapesirave publike te bashkise bashkise. Planifikimi ne buxhet per kete detyrim eshte **6,050 mije leke** e cila perfshin te gjitha kontratat e lidhura me UK per gjelberimin, konsum ne shkolla kopeshte dhe cerdhe si dhe konsumi ne zyrat administrative. Edhe planifikimi i kesaj shume eshte ne rritje per vete faktin e vitit aktual ku vetem faturat e ujit ne gjelberim arriten ne 2,500 mije leke ku brenda ketij detyrimi eshte edhe papergjegjshmeria e punonjesve te ketij sektori.

Sherbimi postar mbetet nje mjet komunikimi i domosdoshem per tu planifikuar per vitin 2020 ne vleren **1,200 mije leke**. Posta gjithashtu paguhet per sherbimin qe ben ne shperndarjen e Ndihmes Ekonomike, Paaftesise dhe grupit te invalideve ne bashkine qender dhe Njesine Administrative ne rolin e agjentit tatimor ne masen 0.4% per bashkine Sarande dhe 0.8% per Nj.A Ksamil.

Sherbimi telefonik permes telefonise fikse , dhe sherbimi i iternetit eshte nje tjeter shume e planifikuar ne buxhetin e 2019.

Nje tjeter forme komunikimi eshte *shpallja dhe publikimi i njoftimeve zyrtare* ne media. Ky sherbim eshte i domosdoshem per permbushjen e detyrimit per komunikim dhe transparence me qytetaret. Gjithashtu ky sherbim perfshin printime dokumentacionesh, apo publikime te tjera abonime per shtypin e perditshem per vitin 2020 eshte planifikuar ne vleren 1,500 mije lek.

Shpenzime per sherbim ne kancelari dhe shtypshkrime eshte i planifikuar ne buxhetin 2020 ne shumen 3,860 mije leke, per furnizimin normal te administrates me kancelari, leter ,bojra per printime dhe fotokopje qe t'u mundesojne punonjesve permbushjen e detyrave dhe objektivave.

Mjete dhe sherbime higjeno- sanitare per institucionine bashkise si edhe per njesite ne varesi, kopeshte cerdhe shkolla etj.


Shpenzime per buqeta lulesh per ngjarje ceremonial per figurat e artit, sportit, politikes etj, kurora per raste festash apo data perkujtimore eshte nje ze tjeter shpenzimesh per administraten.

Shpenzime per *mirembajtje te mjeteve te transportit* si dhe dhe pagesat *per taksave* si dhe *shpenzime karburanti* e llogaritur ne baze normative harxhimi per cdo mjet transporti ne pronesi te bashkise si dhe levizjes se nevojshme, eshte shuma e planifikuar ne shpenzimet operative te adminitrates.

Shpenzime per paisje me uniforme te policise, eshte llogaritur ne baze te numrit te efektiveve te policies si dhe ne zbatim te ligjit 8224, date 15.05.1997 i azhornuar me ligjin Nr.8335 datë 23.04.1998 "Per organizimin dhe funksionimin e policies bashkiake". Qellimi eshte te ofroje sherbim te standartizuar ndaj komunitetit, rritja e imazhit perballe komunitetit me nje prezantim sa me me dinjitoz te Policise Bashkiake.

Shpenzime per mirembajtje te paisjeve informatike. Paisjet elektronike kane nje norme amortizimi te larte vjetor duke i bere ato te zevendesueshme ne nje kohe te shkurter. Shpenzimi permban vetem koston e materialeve pasi sherbimin e kryen specialisti i TIK.

Grafiku13 . *Shpenzimet per materiale dhe mirembajtje administrative*



	Materiale zyre kancelari	Materiale speciale	Elektricitet,uje ,tel,posta	Sherbime sigurie dhe mirembajtje	Shpenzime transporti	Shpenzime udhetimi	Qeramarie	Pritje e percjellje	Mirembajtje asetesh
Column1	4,360	1,860	40,410	15,048	4,700	1,100	1,600	1,500	5,200

*Shpenzime per mbeshtetje te organeve te zgjedhura, Keshillit Bashkiak dhe Krytaret e fshatrave.*Kjo pagese eshte detyrim i institucionit qe te kryhet ne formen e honorareve dhe kompesimeve ne perputhje me aktet ligjore ne fuqi. Synimi i bashkise eshte shperblimi ne kohe i anetareve te Keshillit Bashkiak , dhe Krytaret e fshatrave, shperblim ky i miratuar nga KB ne baze te legjistacionit ne fuqi ne vleren *4,822 mije leke*. Ne buxhet eshte e planifikuar edhe shuma e shpenzimeve operative per Keshillin Bashkiak e cila do te sherbeje per funksionimin e keshillit, per rritjen e performances se funksionimit dhe mbulimi i shpenzimeve per udhetime dhe dieta ne rastet kur marrin pjese ne takime apo trajnime ne perputhje me detyren e tyre ne vleren *7,400 mije leke.*

- ***Shpenzime administrative***


Planifikimii buxhetimit per kete program eshte; per paga dhe sig shoqerore planifikimi eshte ne vleren 109,437 mije leke me nje rritje prej 3% ne terma vjetore, *shpenzime operative* jane planifikuar ne vleren 124,190 mije leke me nje tkurrje ne vleren 9,528 mije leke dhe *shpenzimet per investimet* kapitale ne shumen 247,724 mije leke.

Tabela 6. *Shpenzimet e buxhetuara ne programin e administrative.*

/000leke

Programi	Paga+sigurime	Shpenzime operative	Fondi i vecante	Investime	Totali
Shpenzimet administrative	109,437	124,190	1,000	247,724	482,351

***Grafik 14**. Shpenzimet administrative sipas natyrës .*



- ***Programi i Sherbimeve Publike***

Buxhetimi i programit te sherbimeve publike dhe organizimi i tyre ndahet ne tre drejtime;

1. *Funksionimi dhe financimi i Ndermarrjes se sherbimeve publike.*

   Krijimi i kesaj njesie ne varesi te bashkise eshte bere me qellimin e qarte per te qene nje njesi me vete me organizim, me mjetet dhe kapacitetet e duhura financiare dhe njerezore, te perqendruar dhe te specializuar per te permbushur kerkesat e komunitetit ne marrjen e sherbimeve publike ne menyren dhe cilesine e duhur. Me venien ne dispozicion te kesaj njesie bashkia ka "doren" e saj ne cdo cep te hapesires territorial te saj. Me miratimin e nje strukture prej 102 punonjesish nga bashkia, kupohet edhe rendesia dhe perparesia qe i jepet ketij sektori. Buxheti i planifikuar per vitin 2020 eshte **82,410 mije leke** i cili ze rreth 11% te totalit te buxhetit nga te ardhurat e veta. Fondi i pagave eshte planifikuar me nje rritje prej 3,500 mije leke duke parashikuar rregullime ne strukturen e pagave te kesaj njesie.

   Funksionet kryesore te kesaj ndermarje jane:

   - Mirembajtje ne rrjetin elektrik te ndicimit rrugor ku perfshihen nderrim te pjeseve te demtuara te rrjetit ekzistues.
   - Mirembajtja e infrastruktures publike, trotuare, kangjella dhe ambiente te perbashketa, e cila konsiston ne zevendesimin dhe riparimin e pjeseve te demtuara.
   - Mirembajtje dhe shtim te gjelberimit ne lulishtet e qytetit, e cila perfshin zevendesim lulesh, ujitje dhe mirembajtje bari, mirembajtje dhe krasitje pemesh ne gjithe hapesiren e bashkise si dhe zevendesim te atyre qe demtohen ne hapesirat publike si dhe mirembajtje shatervanesh.

- Mirembajtje ambientesh higjenike publike ne qytet.
- Mirembajtje, vendosje dhe heqje te dekorit te qytetit,si dhe zevendesim te pjeseve te demtuara.

  Duke pasur prasysh se numri i punonjesve ne kete sektor ka qene ne ne rritje do te kemi ne vemendje uljen e kostove te sherbimeve publike pasi keta dy tregues jane ne propocion me njeri tjetrin.

Shpenzimet per mirembajtjen ndricimin publik eshte zeri kryesor ne programin e sherbimeve publike i cili eshte planifikuar **4,000 mije lek**. Ketu perfshihet vetem mirembajtja e e rrjetit ekzistues edhe per shkak te amortizimit , zevendesimi i ndricuesve te djegur dhe zevendesime kablli ne raste difektesh ne rrjet. Ne nryshim nga viti 2019 planifikimi per shtim linjash eshte perfshire ne zerin investime publike, duke bere edhe nje rregullim ne kanalizimin korrekt te fondeve. Per ndricimin publik parashikohet shuma **35,000 mije** lek vetem per energjine elektrike ne buxhetin e bashkise.

Shpenzime per gjelberimin eshte i planifikuar 3,000 mije lek ne buxhet; Ne kete ze shpenzimesh perfshihen mirembajtja e 40,000 m² sip te gjelberuara Sarande dhe ksamil (29,500 m²/6500m²). Gjithashtu ketu perfshihen edhe biopreparatet qe sherbejne per eleminimin e semundjeve te pemeve dekorative te qytetit,zevendesimin e pemeve te demtuara, mirembajtjen e tyre si dhe mbjellja e luleve stinore neper lulishte.

Shpenzime per mirembajtje te infrastruktures publike jane planifikuar 3,500 mije lek ne buxhet. Ne buxhetin e vit te kaluar u planifikuan dhe u realizuan investime ne mjete transporti dhe mjete te renda per Ndermarjen e Sherbimeve me qellimin e vetem per uljen e kostos se sherbimeve publike ne infrastrukture si dhe kryerjen e ketyre sherbimeve ne nje kohe sa me te shkurter.

*Shpenzime per dekorin i planifikuar 2,500 mije lek ne buxhetin e vitit 2020***.** Ketu parashikohen dekoret per Saranden dhe njesite administrative ne te gjithe territorin e bashkise perfshire zbukurimet festive per gjate gjithe vitit .

Mirembajtje te infrastruktures publike i planifikuar 3,760 mije lek ne buxhet, duke zbritur fondi prej 3,000 mije lekesh i planifikuar per mbushje gropash ne vitin 2019 i cili u perfshi ne investimet publike per buxhetin 2020. *Ne kete ze buxhetor perfshihen*:

- Riparim trotuare me pllaka betoni,
- Ndertim mur tulle dhe betoni,
- Kuneta me pllaka guri, bordure pemesh,
- Bojatisje kangjellash e kende lojnash,
- Mirembajtje dhe zevendesim kangjella, puseta dhe kapak pusetash.

2. Pastrimi dhe largimi i mbetjeve

Planifikimi per vitin 2020 per pastrimin e qytetit nga mbetjet urbane si dhe largimi i tyre eshte i pandryshuar me nje vitin aktual ne vleren 67,000 mije leke. Preventivi i hartuar per kete sherbim perfshin te gjithe zerat e pastrimit, denzifektimit, larjes dhe gjithcka tjeter qe ka te beje me higjenen e qytetit.

3. *Shpenzimet per perpunimin e mbetjeve* ne Landfillin e Bajkaj jane planifikuar 25,000 mije leke Perllogaritja e ketij fondi behet ne reference te tonazhit te realizuar faktik dhe cmimit/ njesi pej 22 $ te negociuar dhe kontraktuar me Bajkaj Land sh.a.
4. *Fondi i emergjencave*, per vitin 2020 eshte planifikuar 9,000 mije leke gati 80% me i larte se nje vit me pare, per vete situaten qe ndodhet aktualisht vendi jone.

Tabela.7 *Shpenzimet per programin "sherbime publike*":

Programi	Paga+sigurime	Shpenzime operative	Totali
Sherbimet publike	56,050	127,410	193,460

- ***Institucionet arsimore***

Arsimi parashkollor dhe parauniversitar eshte nje tjeter program shpenzimi ne varesi te bashkise me financim ng ate ardhurat e veta. Per kete program jane programuar 27,918 mije leke krahasuar me 19,542 mije leke te nje viti me pare duke e rritur buxhetin e tyre me 42% . Kjo rritje ka si synim sigurimin me personelin e nevojshem te arsimit parashkollor si dhe krijimin e kushteve higjenike dhe sociale sa me te favorshme ne ambientet ku zhvillojne aktivitetin femijet. Ketu perfshihet pagat e personelit per dy kopeshte, dhe cerdhen e femijeve si dhe shpenzimet per ushqimet, shpenzimet operative ku perfshihen edhe energji elektrike, uje, tel , kancelari etj.

Qendra kulturore dhe shume sportet eshte nje nga njesite ne varesi te bashkise me nje buxhet te konsiderueshem prej 23,536 mije leke. Ketu perfshihen fondi i pagave per punonjesit, shpenzime operative per qendren kulturore dhe mirembajtja e stadjumit dhe funksionimet e ekipeve te ndryshme me trajneret e tyre.

Shtepia e femijes financohet nga te atdhurat e bashkise me nje fond te pervitshem prej 1,300 mije leke, kryesisht per shpenzimet e femijeve jorezidente qe frekuentojne kete institucion.

*Qendra Polivalente***.** Kjo qender eshte ditore e frekuentuar nga te moshuar me probleme kryesisht sociale. Financimi i kesaj qendre per pagat, sigurimet dhe shpenzimet operative perballohen nga Ministria e shendetesise dhe mireqenies Sociale, si dhe nga bashkia. Ne buxhetin e Bashkise jane planifikuar 2,510 mije leke, fonde per pagat per aktivitete kulturore dhe argetuese te organizuara ne qender apo udhetime te natyrave relaksuesedhe sociale. Shpenzime planifikohen edhe per mirembajtjen e godines ne te cilen operon kjo qender.

Qendra multifunksionale per personat me aftesi te kufizuara.

Kjo qender tashme eshte nje institucion i mirefillte i shume i nevojshem per familjet me femije me aftesi ndryshe. Bashkia financion te gjithe buxhetin e nevojshem per funksionimin normal dhe me

kushte te favorshme per zhvillimin e aktivitetit ditor te stafit dhe femijet. Kjo qender frekuentohet rregullisht nga rreth 20 femije. Struktura per punonjesit e kesaj qendre eshte planifikuar te jete 7 punonjes kryesisht edukatore dhe punonjes te specializuar per kete kategori femijesh.

Transferta te brendshme te financuara me buxhetin e bashkise ne total eshte **41,500 mije leke** ose **5.6%** e buxhetit. Në këtë zë është përfshirë gjithashtu edhe fondi prej **10,000 mije Lek**, që do të shërbejë për pagesën e detyrimeve të Bashkise Sarande lidhur me shlyerjen e vendimeve gjyqësore të formës së prerë kryesisht per kontrata sherbimesh te mbartura nder vite, per personelin e larguar nga sherbimi civil ne menyre te jashteligjshme, si dhe shpronesime te natyrave te ndryshme.
Jane planifikuar **19,500 mije lek** per klub sport "Butrinti sh.a" detajimi i ketij fondi do te jete bashkengjitur ketij relacioni. Nje nga zerat e kesaj transferte eshte edhe ajo e ndihmes ekonomike qe eshte planifikuar **5,000 mije lek.** Detyrime e keshillit te qarkut **2,000 mije leke**, fondi i kontogjences, **3,000 mije leke** dhe fondi reserve **2,000 mije leke** jane pjese perberese e programit te "transfertes se brendshme"

Tabela.8 *Shpenzimet per programet e "njesive te varesise"*:

Programi	Paga+sigurime	Shpenzime operative	Totali
Institucionet e varesise	42,280	28,195	70,475


2.1.2 Shpenzimet e kryera me fonde nga transferta sektoriale.

1- *Konvikti i shkolles se mesme***,** me nje fond prej **18,371** mije lek i financuar nga buxheti i shtetit me destinacion funksionimin e konviktit per shkollen e mesme profesionale "Antonio Athanas". Ky fond eshte i destinuar per paga personeli per nje staf prej 12, shpenzime operative dhe investime ne funksion te ketij institucioni.
2- *Arsimi parashkollor,* i cili perfshinte gjithe punonjesit mbeshtetes te arsimit te parashkollor gjithesej **73** punonjes me nje fond **59,995** mije leke per paga dhe sigurime shoqerore.
3- *Arsimi parauniversitar***,** po ashtu perfshin personelin mbeshtetes te shkollave te mesme prej **5** punonjesish me nje fond prej **3,543** mije lek per pagat dhe sigurimet shoqerore.
4- *Mbrojtja nga zjarri***,** ka transferuar te gjitha kopetencat dhe detyrimet ne Bashki me nje personel prej **17** personash dhe fond **17,743 mije lek** nga te cilat 15,905 mije lek per paga dhe sig shoqerore si dhe 1,831 mije lek per shpenzime operative.
5- *Administrimi i pyjeve***,** me nje personel prej **3** punonjesish dhe fond page **1,591** mije lek, 266 mije lek sigurime shoqerore dhe 481 mije lek shpenzime operative,gjithashtu kane transferuar kopetencat dhe detyrimet ne Bashkine e Sarandes.

***Tabela 8**. Programet e transfertes sektoriale*

Programi	Paga+sigurime	Shpenzime operative	Investime kap	Totali
Funksionet e deleguara	83,425	13,397	3,775	101,989

Grafiku 15 *struktura e financimit te Funksioneve te deleguara.*



2.1.3 Shpenzimet e kryera me fonde nga transferta e kushtezuar

Bazuar në klasifikimin ekomomik, shpenzimet e kryera me fonde të kushtëzuara janë të përqendruara në dy zëra kryesorë: transferta për buxhetet familjare (ndihmë ekonomike, pagesa e paaftësisë etj.) dhe shpenzimet kapitale apo investimet (përfshirë FZHR). Ndaj totalit të transfertave të kushtëzuara, fondet e alokuara nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale përfaqësojnë rreth 50.1% ndaj totalit ose rreth **215,000 mije lekë** ne te njejtat nivele me nje vit me pare. Fondet e alokuara për shpenzime kapitale jane planifikuar me nje rritje prej 21% ne vleren **200,000 mije leke**.

- ***Sherbimi Social***

Me financim nga buxheti i shtetit trajtohen me ndihme trajtohen rreth 230 familje. Me hyrjen e ligjit te ri per ndihmen ekonomike, ka ndryshuar menyra e trajtimit te familjeve me ndihme ekonomike, perfshire ketu edhe familjet qe trajtohen me te ardhurat e bashkise, qe ne menyren e aplikimit e cila behet ne sistemin e administruar dhe vleresuar nga sherbimi social rajonal, dhe me kritere te barabarta me familjet qe perfitojne nga buxheti i shtetit. Aplikimet kryhen nga data 1-10 te cdo muaji. Nga Buxheti i shtetit trajtohen **1,870 persona** me aftesi te kufizuara.

Sherbime te deleguara te QKB dhe Gjendjes Civile (paga, sigurime dhe shpenzime operative) jane funksione te deleguara per qeverisjen vendore, ne baze te ligjit Nr.139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" dhe ne cdo rast funksionet e deleguara shoqerohen me transferta te qeverisjes qendrore per te financuar kostot e veprimtarive te ketyre funksioneve. Delegimi ka te beje me mbeshtetjen qe ju ofron bashkia si financiare ashtu edhe logjistike ne menyre qe te garantohet funksionimi i tyre.

3. *Investimet Kapitale.*

3.1 Investimet me financim nga buxheti i shtetit.

Per vitin 2020 jane planifikuar ne vleren 200,000 leke fonde per tu projekte qe priten te miratohen nepermjet insrumentit te qeverise qendrore per financimet e investimeve kapitale vendore, FZHR. Parashikohet te financohen projekte *ne infrastrukturen rrugore*, shume te domosdoshme per funksionimin normal te Sarandes kryesisht sezonit veror ku popullsia jorezidente shumefishon ate rezidente dhe kapacitetet normale te hapesires publike per qarkullim rrugor. Gjithashtu edhe *per infrastrukturen arsimore* jane depozituar prane zyrave perkatese te financimit te projekteve nga fondet e qeverise per investime te cilat jane jashte kapaciteteve financuese te bashkise.

1- Investimet me financim nga te ardhurat e bashkise


Planifikimi i fondit per investimet publike ng ate ardhurat e bashkise eshte ne vleren **208,724 mije leke.** Per planifikimin e investimeve nga burimet e veta per gjithe territorin e bashkise u punua nga grupi i hartimit te buxhetit. U moren kerkesat ne te gjitha degjesat publike qe u organizuan per hartimin e buxhetit 2020 dhe u klasifikuan sipas prioriteteve. U planifikuan ato investime te cilat perbenin domosdoshmeri ne komunitet, kryesish ato qe kane te bejne me infrastrukturen rrugore, kanalizimet e ujrave, sistemimet e hapesirave publike, nderhyrje ne infrastrukturen arsimore etj

Te ndara sipas programeve buxhetore;

1- *Investime per administraten* eshte planifikuar ne vleren **11,500 mije leke**,te cilat kane te bejne me rikonstruksionin e godines se bashkise dhe blerje paisjesh elektronike per te zevendesuara ato qe jane tejet te amortizuara.
2- *Menaxhim te tokes bujqesore* eshte planifikuar **2,000 mije leke**. Ne kete program jane planifikuar nderhyrje ne kanalizimet dhe rehabilitimin e tyre ne fshatin Cuke.
3- *Rruge rrjete dhe transport publik* eshte planifikuar ne **vleren 123,835 mije leke** . Jane perfshire nevojat me imediate ne infrastrukturen e rrugeve dhe transportin publik te Sarandes, Ksamilit, Cuke Berdenesh, Metoq, Shelegar, Manastir.
4- *Investime ne sherbimet publike*, jane planifikuar ne vleren **37,591 mije leke**. Eshte mbajtur ne vemendje sistemimi i hapesirave publike me kende lojnash, sinjalistikat si dhe nderhyrje neper lagje me sistemime rrugesh me beton.

5- *Investime ne rrjetin ujesjelles kanalizime* eshte planifikuar ne vleren **10,857 mije leke.** Kerkesat me emergjente kane qene per nderhyrje ne kanalizimet e ujerave te bardha e te zeza ne lagjet e Sarandes por edhe ne fshatra.
6- *Investime ne arsim* jane planifikuar **13,442 mije leke.** Eshte planifikuar nderhyrje kryesisht ne shkollat 9 vjecare per eleminimin e problematikave nga me te ndryshimet.
7- *Investime ne kulture* dhe art jane te planifikuara ne buxhet ne vleren **6,500 mije leke.** Jane planifikuar kryesisht rikonstruksion te terreneve sportive ne brendesine e territorit te shkollave.


Grafiku 16. *Investimet ng ate ardhurat e vet ate ndara sipas programeve ne 000/leke*



Te ndara sipas ndarjeve territoriale;

1- Saranda eshte planifikuar ne vleren 152,224 mije leke.
2- Ksamili eshte planifikuar ne vleren 28,000 mije leke.
3- Metoqi eshte planifikuar ne vleren 5,500 mije leke.
4- Gjashta eshte planifikuar ne vleren 10,000 mije leke.
5- Cuka eshte planifikuar ne vleren 7,500 mije leke.
6- Berdenesh& Manastir eshte planifikuar ne vleren 5,500 mije leke.

Grafiku 17 *Investimet sipas ndarjeve administrative ne 000/leke*



Me realizimin e ketij buxheti synojme te jemi ne permbushje te kerkesave te gjithe komunitetit te Bashkise, me qellim qe jo vetem te perafrohemi gjithnje e me shume standarteve normale te jeteses, por te jemi ne nje hap me zhvillimin dhe rritjen e synimit si destinacion turistik te Sarandes, duke qene ne lartesine e duhur ne ofrimin e infrastruktures ne teresine e saj. Ne kete menyre ju permbahemi premtimeve qe kemi dhene dhe detyrimeve qe kemi marre persiper ne momentin qe morem detyren ne sherbim te Bashkise Sarande dhe qytetareve te saj. Me punen dhe vullnetin tone, dhe sigurisht edhe me mbeshtetjen tuaj jemi te bindur qe do te realizojme te gjitha objektivat tona ne sherbim te qytetareve te Sarandes!